



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

**UDHËZIM ADMINISTRATIV NR. 03/2025 KUSHTET DHE
PROCEDURAT PËR USHTRIMIN E VEPRIMTRAIË
SHËNDETËSORE SPITALORE DHE QENDRAVE REHABILITUESE**

Ministri i Ministrisë së Shëndetësisë,

Në mbështetje të nenit 25 paragrafi 3, neni 34 të Ligjit Nr. 04/L-125 për Shëndetësi, neni 11, paragrafi 1, nën paragrafi 1.5 të Ligjit Nr.08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës (GZ. 34 / 18 nëntor 2022),

Nxjerr:

**UDHËZIM ADMINISTRATIV NR. 03/2025 KUSHTET DHE PROCEDURAT PËR
USHTRIMIN E VEPRIMTRAIË SHËNDETËSORE SPITALORE DHE QENDRAVE
REHABILITUESE**

**Neni 1
Qëllimi**

Ky Udhëzim Administrativ rregullon procedurat e licencimit, kushtet e përgjithshme dhe specifike për hapësirën, pajisjet dhe kuadrin profesional organizimin, funksionimin dhe mbikëqyrjen e veprimtarisë shëndetësore në spital dhe qendër rehabilituese

**Neni 2
Fusha e veprimit**

Dispozitat e këtij Udhëzimi Administrativ vlejné për të gjitha Institucionet shëndetësore të kujdesit spitalor dhe qendër rehabilituese.

**Neni 3
Përkufizime**

1.Shprehjet, termat dhe shkurtesat e përdorura në këtë udhëzim administrativ, kanë kuptimin si në vijim:

1.1. **Spitali** - institucion shëndetësor që ofron shërbim të kujdesit shëndetësor ambulatorë, diagnostifikim, stacionar, trajtim dhe rehabilitim 24 orë.

1.2. **Spital i Përgjithshëm**- institucion shëndetësor i cili ofron shërbime të kujdesit shëndetësor multidisciplinar.

1.3. **Spital Special**- institucion shëndetësor që ofron shërbime shëndetësore të specializuara në një deri katër fushë mjekësore.

1.4. **Qendër rehabilituese**- institucion shëndetësor që ofron shërbime shëndetësore dhe rehabilituese që ndihmon: rikthimin, mbajtjen dhe përmisimin e aftësive që nevojiten për jetën e përditshme.

1.5. **BLIPSh**- (Bordi për licencim të institucioneve private shëndetësore) organ administrativ për licencimin e institucioneve private të kujdesit shëndetësor (tani e tutje Bordi);

1.6. **Licenca/vendimi për licencim**- dokument me shkrim i lëshuar nga Ministria e Shëndetësisë me të cilin lejohet veprimtaria private e institucionit shëndetësor;

- 1.7. **OPSHK**-Odat e profesionistëve shëndetësor të Kosovës;
- 1.8. **DLISH**-Divizioni për licencim të institucioneve shëndetësore;
- 1.9. **IPSH**-Institucioni privat shëndetësor;
- 1.10. **BLPSH**-Bordi për licencim të profesionistëve shëndetësor;
- 1.11. **AKMRrSB**-Agjencia e Kosovës për mbrojtje nga rrezatimi dhe siguria bërthamore;
- 1.12. Kontrata për asgjësimin e mbetjeve medicinale;
- 1.13. **IS** – Inspektorati sanitar;
- 1.14. **ShSKUK**-Shërbimi Spitalor Klinik Universitar i Kosovës;
- 1.15. **AKK**- Asociacioni i Komunave të Kosovës.

2. Shprehjet, termat dhe shkurtesat tjera të përdorura në këtë Udhëzim Administrativ kanë kuptimin ashtu siç janë të përcaktuara me legjislacionin në fuqi.

KAPITULLI I

PROCEDURAT PER LICENCIM, OBLIGIMET DHE TAKSA ADMINISTRATIVE PËR INSTITUCIONET PRIVATE SHËNDETËSORE SPITALORE

Neni 4 Aplikimi për licencë

1. Personi juridik ose fizik aplikon për licencim përmes qasjes në modulin e aplikimit elektronik në ueb faqen e Ministrisë së Shëndetësisë/DLISH.
2. Udhëzuesi për aplikim elektronik nga paragrafi 1 publikohet në ueb faqen e Ministrisë së Shëndetësisë.
3. Institucioni që aplikon për veprimtari shtesë dhe ndërrim të lokacionit (adresës) i nënshtrohet procedurave të njëjta të aplikimit për licencim dhe taksës administrative të përcaktuar me këtë udhëzim administrativ.
4. Dokumentacioni i nevojshëm për licencimin e institucionit privat shëndetësor spitalor:
 - 4.1 Certifikata e regjistrimit të biznesit
 - 4.2 Statuti i bazuar në Ligjin për shëndetësi;
 - 4.3 Pëlqimi sanitar i lëshuar nga Inspektorati sanitar
 - 4.4 Deklarata nën betim
 - 4.5 Dokumenti identifikues për themeluesin, drejtorin e institucionit;

- 4.6 Licenca dhe dokumenti identifikues për kuadrin profesional
- 4.7 Kontrata për furnizim me gjak dhe produkte të gjakut
- 4.8 Kontrata për shërbimin e morgut;
- 4.9 Kontratë për menaxhimin e mbeturinave të rrezikshme (medicinale);
- 4.10 Shërbimet mbështetëse të kontraktuara në rast se nuk janë të siguruara nga vet institucioni;
- 4.11 Planimetria e objektit e firmosur dhe e vulosur nga një arkitekt/inxhinier i licencuar;
- 4.12 Licenca për institucionet shëndetësore që aplikojnë rreze jonizuese dhe jo-jonizuese e lëshuar nga organi kompetent;
- 4.13 Pagesa e taksës administrative;
- 4.14 Formulari vetë-vlerësues i plotësuar nga vet aplikuesi.

Neni 5

Kuadri profesional

1. Kuadri profesional në institucionin privat shëndetësor të licencuar ofron shërbime shëndetësore nëse:
 - 1.1 është i licencuar nga Odat përkatëse e profesionistëve shëndetësor;
 - 1.2 kuadri profesional/bashkëpunëtori profesional shtetas i huaj që ofron shërbime shëndetësore nëse i është i lejuar nga Ministria e shëndetësisë;
 - 1.3 Bashkëpunëtor profesional me shkollim jashtë lëmisë së mjekësisë me dëshmi përkatëse për lëmi të caktuara.

Neni 6

Themelimi i Institucionit Shëndetësor

1. Institucioni privat shëndetësor themelohet në pajtim me dispozitat ligjore të ligjit për shëndetësi.
2. Personi fizik, juridik, subjektet tjera vendore dhe të huaja mund të themelojnë institucion privat shëndetësor në pajtim me kushtet e parapara me ligjin për shëndetësi, këtë udhëzim administrativ dhe aktet tjera juridike me legjislacionin në fuqi.

Neni 7

Detyrat dhe obligimet e spitaleve

1. Spitali obligohet të:
 - 1.1 Zbatojë dispozitat juridike lidhur me ofrimin e shërbimeve shëndetësore,
 - 1.2 Zbatoj standardet e miratuara në sektorin e shëndetësisë,

1.3 Nxjerrjen e statutit,

1.4 Vendos në vend të dukshëm listën e çmimeve për shërbimet që ofron,

1.5 Sigurojë kuadër profesional nga lista e paraqitur e shërbimeve të ofruara,

1.6 Ruaj dokumentacionin dhe regjistrat mjekësore në gjendje funksionale, për periudhën kohore të përcaktuar me ligj,

1.7 Ruaj dokumentacionin shëndetësor nëse shuan veprimtarinë respektivisht pushon së funksionari veprimtarinë e tij në pajtim me dispozitat juridike,

1.8 Sigurojë qasje personave me aftësi të kufizuar,

1.9 Sigurojë përgjegjësinë civile për dëmet e shkaktuara ndaj shëndetit të qytetarëve gjatë shfrytëzimit të shërbimeve shëndetësore në institucion, në pajtim me Ligjin për të drejtat dhe përgjegjësit e qytetarëve në kujdesin shëndetësor,

1.10 Të raportoj për aktivitetet e veta në pajtim me ligjet dhe aktet nënligjore në fuqi,

1.11 Të siguroj vazhdimin e kujdesit shëndetësor qytetarëve në rast se për çfarëdo arsye nuk mund të siguroj shërbime të caktuara të kujdesit shëndetësor,

1.12 Të sigurojë referimin e qytetarëve në bazë të ligjit dhe të akteve përkatëse nënligjore,

1.13 Të siguroj zbatimin e dispozitave ligjore që kanë të bëjnë me metodat dhe procedurat për kontrollin, ruajtjen, shpërndarjen dhe administrimin e barërave,

1.14 Të azhurnoj njohuritë dhe shkathtësitë profesionale të personelit shëndetësor përmes procesit të zhvillimit të vazhdueshëm profesional, konform rregullativës ligjore të aprovuar nga Ministria e Shëndetësisë,

1.15 Të siguroj mekanizma për një sistem efikas për vlerësim dhe monitorim,

1.16 Të zbatojë imunoprofilaksën e obliguar dhe fushatat e imunizimit dhe fushatat e imunizimit plotësues në bazë të kushteve të përcaktuara me Udhëzimin Administrativ përkatës për Vaksinoprofilaksën, Seroprofilaksën dhe Kimioprofilaksën,

1.17 Mënyra e plotësimit të recetës dhe obligimi i spitalit për raportim është i përcaktuar në bazë të Udhëzimit Administrativ përkatës për Recetat në sistemin shëndetësor në Republikën e Kosovës,

1.18 Plotësimin e dokumenteve shëndetësore në bazë të Udhëzimit Administrativ përkatës për Dokumentet Shëndetësore,

1.19 Zbatimi i rregullave dhe masat e parandalimit dhe transmetimin e HIV-AIDS në bazë të Udhëzimit Administrativ përkatës për Veprimtaria, struktura dhe funksionet e shërbimeve shëndetësore për HIV-AIDS,

1.20 Organizimin e shërbimit për parandalimit dhe kontrollit të infeksioneve përmes ekipit për

kontrollin e infeksioneve spitalore dhe detyrën që të plotësoj kushtet në bazë të Udhëzimit Administrativ përkatës për parandalimin dhe kontrollin e infeksioneve spitalore,

1.21 Spitali që angazhon profesionist shëndetësor obligohet t'i plotësoj kushtet e përcaktuara me Udhëzimin Administrativ përkatës për licencim të përkohshëm të profesionistëve shëndetësor qytetar jo-kosovar,

1.22 Të siguroj zbatimin e dispozitave ligjore që kanë të bëjnë me metodat dhe procedurat për kontrollin, ruajtjen, shpërndarjen dhe administrimin e barërave,

1.23 Menaxhimin e mbeturinave medicinale sipas dispozitave në fuqi,

1.24 Të informojë përmes modulit të licencimit elektronikë para shuarjes, shtimit të shërbimeve shëndetësore, ndërprerjes së përkohshme të veprimtarisë shëndetësore, plotësimin apo largimin e personelit shëndetësor,

1.25 Institucioni spitalore obligohet për parandalimin dhe kontrollin e infeksioneve,

1.26 Institucioni privat shëndetësor obligohet që në vend të dukshëm të vendosë:

1.26.1 Licencën e institucionit të lëshuar nga Ministria e shëndetësisë,

1.26.2 Kutinë e ankesave/rekomandimeve,

1.26.3 Listën e shërbimeve me çmime,

1.26.4 Kartën e të drejtave dhe përgjegjësisë të pacientit,

1.26.5 Numrin e linjës telefonike për ankesat e qytetarëve,

1.26.6 Shenjën për ndalim të pirjes së duhanit.

1.27 Të kryej dhe zbatoj obligimet tjera të përcaktuara me ligjet dhe aktet nënligjore në fuqi.

Neni 8

Formulari i vetëvlerësimit

1. Formulari i vetëvlerësimit të kushteve, hapësirës dhe pajisjeve mjekësore të institucioneve private shëndetësore është unik.

2. Formulari i vetëvlerësimit është pjesë e modulit për aplikimin e Institucioneve Private Shëndetësore në ëeb faqe të Ministrisë së Shëndetësisë dhe plotësohet nga aplikuesi.

Neni 9

Bordi për licencim të institucioneve private shëndetësore

1. Bordi është organ i emëruar nga Ministri i Shëndetësisë dhe përbëhet nga pesë (5) anëtarë:

1.1 Përfaqësuesi nga MSH;

- 1.2 Jurist nga MSh;
- 1.3 Përfaqësues nga OPSH-ve;
- 1.4 Përfaqësues nga ASK;
- 1.5 Përfaqësues nga DCSALISH.

Neni 10

Mandati i Bordit

1. Kryesuesi dhe anëtarët e Bordit emërohen me afat kohor tre (3) vjeçar me mundësi vazhdimi.
2. Mandati i anëtarit të Bordit përfundon në këto raste:
 - 2.1 Pas skadimit të mandatit;
 - 2.2. Pas dhënies së dorëheqjes me shkrim;
 - 2.3 Në rast të mospërputhjes së obligimeve të përcaktuar me këtë udhëzim administrativ, rasteve të shkeljeve ligjore apo disiplinore dhe rasteve të konfliktit të interesit.

Neni 11

Kompetencat e Bordit

1. Bordi shqyrton dokumentacionin e institucioneve private shëndetësore për licencim, rilicencim, ndryshim të lokacionit (adresës), veprimtarisë shtesë, ndërrimit të emrit të institucionit shëndetësor, transferimit të licencës, pezullimit të licencës dhe atë jo më vonë se pesëmbëdhjetë (15) ditë kalendarike pas pranimit të dokumentacionit nga DLAISH.
2. Licencon, rilicencon, refuzon, pezullon, revokon dhe shfuqizon licencën e institucionit privat të kujdesit shëndetësor.
3. Licencon institucionin në rast të plotësimit të kushteve të përcaktuara me legjislacionin në fuqi.
4. Refuzon kërkesën e aplikuesit për licencim në rast të mos plotësimit të kushteve të përcaktuara me legjislacionin në fuqi.
5. Pezullon licencën nëse konstatohet nga organi kompetent se institucioni i licencuar ka dhënë deklaratë jo të saktë si dhe kur vepron në kundërshtim me legjislacionin në fuqi.
6. Shfuqizon vendimin për pezullim të licencës kur konstatohet nga organi kompetent se institucioni shëndetësor i ka plotësuar kushtet dhe është në harmoni me legjislacionin në fuqi.
7. Shfuqizon ose pezullon licencën e institucionit privat shëndetësor në rast të inicimit të procedurës për shfuqizim/pezullim nga Ministri/Inspektorati Shëndetësor ose organi kompetent.
8. Aprovon kërkesën për shuarje të një ose me shumë veprimtari shëndetësore të institucionit shëndetësor të licencuar vetëm në ato raste kur institucion bënë kërkesën me vetë dëshirë dhe nuk ka obligime të pa kryera ndaj Ministrisë së Shëndetësisë.

9. Aprovon kërkesën e institucionit shëndetësor për ndryshim të emrit të institucionit vetëm në ato raste kur nuk ka obligime të pa kryera ndaj Ministrisë së Shëndetësisë si dhe kur merret certifikata e biznesit me emër të ri, paguhet taksa administrative, nuk ndryshon veprimtaria shëndetësore dhe kuadri profesional është sipas dispozitave ligjore në fuqi.

10. Transferon licencën nga një subjekt në subjekt tjetër mund të bëhet vetëm në ato raste kur ka pajtueshmëri të dëshmuar në mes subjekteve dhe kur nuk ka obligime të pa kryera ndaj Ministrisë së Shëndetësisë.

11. Licenca mund të transferohet nga një themelues në themelues tjetër.

12. Raporton për Ministrin në afate periodike.

13. Nxjerr rregulloren e brendshme të punës.

14. Bordi duhet të ketë sekretarin teknike.

15. Shqyrton çështje tjera të cilat kanë të bëjnë me institucionet private shëndetësore.

16. Bordi nxjerr vendim/licencë për çështjet nga paragraf 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10 dhe 11 të këtij neni.

17. Në rast se nuk është rregulluar ndryshe me këtë Udhëzim Administrativ, autoriteti kompetent zbaton procedurën e përgjithshme administrative.

Neni 12 **Lëshimi i licencës**

1. Licenca e institucionit privat shëndetësor nënshkruhet nga Kryesuesi i Bordit dhe Ministri.

2. Licenca ka datën e lëshimit dhe datën e skadimit.

3. Licenca është e vlefshme për periudhën pesë (5) vjeçare.

4. Licenca mund të jetë objekt i transferimit nga një subjekt në subjektin tjetër.

5. Çdo plotësim/ndryshim i veprimtarisë së institucionit shëndetësor të licencuar vlen deri në datën e skadimit të licencës.

Neni 13 **Detyrat e DLISH**

1. Pas licencimit të Institucionit shëndetësor themeluesi do të informohet përmes sistemit elektronik.

2. DLISH bënë regjistrimin e institucioneve private shëndetësore që kanë aplikuar, licencuar, rilicencuar, refuzuar, revokuar, pezulluar dhe anulimin e licencave.

3. Të dhënat e institucioneve private shëndetësore të licencuara i dërgohen Divizionit të Informimit për publikim në faqen zyrtare të Ministrisë së Shëndetësisë.

Neni 14

Inspektimi dhe mbikëqyrja

1. Inspektimi i institucioneve private shëndetësore bëhet nga organet inspektuese për fushat e caktuar sipas dispozitave ligjore në fuqi.
2. Mbikëqyrja institucioneve private shëndetësore bëhet nga DLAISH.

Neni 15

Procedura e ankesës

1. Komisionin për shqyrtimin e ankesave të aplikuesve të institucioneve private shëndetësore është organ i emëruar nga Ministri i Shëndetësisë dhe përbëhet nga tre (3) anëtarë:
 - 1.1 Përfaqësuesi i MSH;
 - 1.2 Jurist nga MSH;
 - 1.3 Përfaqësues nga OPSh-të.
2. Kundër vendimit të Bordit, aplikuesi i institucioni privat shëndetësor ka të drejtë të parashtrojë ankesë në Komisionin për shqyrtimin e ankesave të aplikuesve të institucioneve private shëndetësore në Ministrinë e Shëndetësisë.
3. Kryesuesi dhe anëtarët e Komisionit të ankesave emërohen me afat kohor dy (2) vjeçar me mundësi vazhdimi.
4. Afati për ankesë është tridhjetë (30) ditë nga dita e marrjes së vendimit.
5. Komisioni për shqyrtimin e ankesave të aplikuesve dhe institucionit shëndetësor shqyrton ankesën brenda 30 ditëve.
6. Shqyrtimit të ankesës do të bëhet sipas Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Neni 16

Kompensimi

Bordi dhe komisioni për shqyrtimin e ankesave kompensohen sipas akteve juridike në fuqi.

Neni 17

Pagesa e taksës administrative

1. Institucioni privat shëndetësor obligohet të paguajë taksën administrative për aplikim, licencim, rilicencim, veprimtarisë shtesë, ndërrim të lokacionit (adresës), të përcaktuar me këtë Udhëzim Administrativ.
2. Taksa administrative e paguar sipas paragrafit 1 të këtij neni nuk kthehet.
3. Taksat paguhen sipas shtojcës një (1) të këtij Udhëzimi administrativ.

KAPITULLI II

Neni 18 Llojet e spitaleve

1. Spitalet në Kosovë varësisht nga lloji i shërbimit që ofrojnë janë:

1.1 Spital i përgjithshëm;

1.2 Spital special.

Neni 19 Lokacioni i spitalit

1. Objekti spitalor duhet t'i plotësoj këto kushte:

1.1 Vend me qasje të lehtë;

1.2 Kriteria hapësinore dhe urbanistike;

1.3 Mirëmbajtje ambient të sigurt për pacient, personel dhe publikun.

Neni 20 Kushtet e përgjithshme spitalore

1. Objekti spitalor ku zhvillohet veprimtaria shëndetësore duhet të ndërtohet në përputhje me standardet ndërtimore të rregulluara me ligjin për ndërtim dhe ligjet e tjera të cilat rregullojnë çështjet e ambientit.

1.1. Mirëmbajtja e hapësirës spitalore:

1.1.1 Mirëmbajtja në mënyrë të rregullt;

1.1.2 Dyshemetë e sallave operative, repartit intenziv dhe dhomave për hospitalizim të pacientave duhen të jenë linoleum ose epoksid kurse pjesa tjetër spitalore mund të jetë keramikë, granit ose material tjetër që pastrohet lehtë me qëndrueshmëri ndaj kemikalieve dhe temperaturave të larta të zjarrit;

1.1.3. Muret duhet të kenë lartësinë së paku 2m e 60cm, duhet të jenë të lëmuara dhe që pastrohen lehtë;

1.1.4. Dritaret të jenë të vendosura për sigurimin e ndriçimit ashtu që të këtë dritë të mjaftueshme;

1.1.5. Hapësirat dhe korridoret qarkulluese duhet të jenë të gjëra, të lira dhe çdo herë në dispozicion për lëvizje të lirë të pacientëve qoftë me shtretër, barelë, apo karroca.

1.2 Qasja në hapësirën spitalore:

1.2.1 Dyert e hyrje-daljeve për qasje të lehtë dhe në përputhshmëri me standardet ndërtimore;

1.2.2 Dalje emergjente nga spitali të jashtme ose brendshme;

1.2.3 Ashensor dhe qasje të lehtë për pacient me shtrat dhe për personat me aftësi të kufizuara.

1.3 Ndriçim i hapësirës spitalore:

1.3.1. Për hapësirat me ndriçim të kufizuar natyror, duhet të siguroj ndriçim artificial me fuqi të caktuar të shprehur në luksa si:

1.3.2. Hapësirat kirurgjikale, njësitë e kujdesit intensiv dhe lindtore prej 500-1000 lluksa;

1.3.3. Për laboratorë 250-500 lluksa;

1.3.4. Për korridore dhe shkallë 40 lluksa;

1.3.5. Drita e murit afër shtretërve të sëmurve 70-100 lluksa;

1.3.6. Të siguroj burime alternative të ujit dhe energjisë me kyçe automatike;

1.4. Ventilim për hapësirat spitalore:

1.4.1. Blloku operativ, lindtoret, hapësirat për kujdes intensiv duhet të kenë sistemin e ventilimit me ajër të kondicionuar me hepafiltera të ndarë nga pjesët tjera spitalore;

1.4.2. Spitali obligohet të siguroj instalim dhe stacion qendror për gazra.

1.5. Kushtet higjienike për hapësirën spitalore:

1.5.1. Spitali shfrytëzon sistemin publik të furnizimit me ujë të pijshëm dhe siguron burime alternative të furnizimit;

1.5.2. Mbeturinat e lëngëta të shkarkohen në sistem të kanalizimit publik;

1.5.3. Mbeturinat e ngurta të mblidhen, trajtohen dhe të hedhen në pajtim me ligjet apo rregullat në zbatim;

1.5.4. Mbetjet medicinale spitalore të të gjitha formave të grumbullohen në enë të veçanta dhe të asgjësohen në përputhje me rregulloret për menaxhimin e mbeturinave mjekësore;

1.5.5. Spitali obligohet të siguroj dhe mirëmbajë ambient të pastër dhe estetik për pacientët, personelin dhe publikun;

1.5.6. Tualetet duhet të kenë qasje të drejtpërdrejtë nga dhomat ose korridoret. Ato duhet të jenë të ndara për pacientë, personel meshkuj dhe femra dhe persona me aftësi të kufizuara;

1.5.7. Spitali dhe objektet tjera përcjellëse duhet të sigurojnë ngrohje sipas standardeve teknike dhe ekologjike.

1.6. Mbrojtja e objektit nga zjarri:

1.6.1. Të ketë mjete për detektimin dhe mbrojtjen nga zjarri;

1.6.2. Alarme zjarri në mure;

1.6.3. Detektorë tymi në tavane;

1.6.4. Pajisjet për shuarjen e zjarrit duhet të jenë të vendosura në cdo kat dhe vende të dukshme, të përshtatshme dhe të validuara nga institucioni gjegjës.

1.7. Spitalet obligohen të sigurojnë:

1.7.1. Vend parkim të mjaftueshëm, siguri për pacientët, personelin dhe pasurinë;

1.7.2. Sistem efektiv grafik si: shenjëzim i shoqëruar me mjete ndihmëse vizuale për informacione, orientim, drejtim, identifikim, ndalim, vërejtje dhe shënime zyrtare themelore për veprim optimal.

Neni 21 **Standardet dhe Radhitja e hapësirave spitalore**

1. Hapësirat e spitalit duhet të jenë të lidhura me njëra tjetrën, funksionale dhe të radhitura sipas zonave:

1.1. Zona e parë: shërbimi i triazhës, ambulator, emergjencës dhe administrativ;

1.2. Zona e dytë: shërbimet diagnostike;

1.3. Zona e tretë: trajtimi konservativ;

1.4. Zona e katërt: trajtimet operative dhe kujdesi intensiv;

1.5. Zona e pestë: shërbimet mbështetëse dhe teknike mund të jenë të vendosura edhe jashtë zonave të frekuentuara ose jashtë objektit spitalor.

2. Hapësirat për veprimtari shëndetësore duhet të kenë sipërfaqe prej:

2.1 Pritorja duhet të jetë sëpaku 24m

2.2 Hapësira për informim 9 m²;

2.3 Dhoma e pranimit 12 m²;

2.4 Dhoma e emergjencës 20m²;

2.5 Hapësira për ambulancë specialistike 12 m²;

2.6 Hapësira për sallat operative së paku 30 m².

3. Veprimtaritë specialistike të degëve operative mund të kenë hapësira të përbashkëta të bllokut operativ, nëse këtë e mundësojnë kushtet teknike-ndërtimore dhe ato të hapësirës së komunikimit në

objektin ku janë të vendosura:

- 3.1 Hapësirat për intervenime të vogla dhe për endoskopi 16 m²;
- 3.2 Hapësirat për laboratorë në kuadër të spitalit minimum duhen të jenë 20 m²;
- 3.3 Hapësira për marrjen e materialit për laboratorë duhet të jetë minimum 9 m²;
- 3.4 Hapësirat për ekzaminime radioimazherike sipas standardeve për objektet me destinim përdorimi të rrezeve jonizuese e jo jonizuese;
- 3.5 Hapësira ku organizohet shpërndarja e ushqimit të jenë minimum 12 m²;
- 3.6 Hapësirat për të sëmurët me sëmundje infektive 12m²;
- 3.7 Hapësirat për kujdes intensiv sepaku 20 m².

Neni 22 **Pajisjet dhe inventari**

- 1. Pajisjet teknike-mjekësore duhet të sigurohen sipas standardeve për veprimtari të caktuara me certifikatë mirëmbajtje, servisim dhe kalibrim të rregullt.
- 2. Pajisjet përcaktohen sipas shërbimeve përkatëse të kujdesit shëndetësor dhe me specifikacionet e bashkëngjitura me këtë udhëzim administrativ dhe udhëzimet tjera në fuqi.
- 3. Sallat e operacionit, kujdesi intensiv dhe hapësirat spitalore me risk të lartë për infeksione duhet të sigurojnë pajisjet të ndara dhe të veçanta për parandalimin e infeksioneve intrahospitalore.

Neni 23 **Personeli**

- 1. Spitali i përgjithshëm obligohet të ketë:
 - 1.1 Personel shëndetësor të licencuar nga Odat e profesionistëve shëndetësor;
 - 1.2 Dy specialist me orar të plotë pune për çdo veprimtari shëndetësore, përjashtimisht pika 3.2 e këtij neni;
 - 1.3 Katër (4) infermier me orar të plotë pune për çdo veprimtari shëndetësore;
 - 1.4 Spitali i përgjithshëm në harmoni me Ligjin e punës dhe aktet e tjera juridike të cilat rregullojnë normat e punësimit, duhet të siguroj personel për organizim të kujdestarive dhe mbulim 24h.
- 2. Spitali special obligohet të ketë:
 - 2.1 Dy specialist dhe 4 infermier me orar të plotë pune për çdo veprimtari shëndetësore;
 - 2.2 Spitali special me një veprimtari duhet të ketë minimum 6 shtretër. Për çdo veprimtari shtesë spitali special duhet shtoj 4 shtretër;

2.3 Spitali special duhet të siguroj shërbimin dhe personelin specialistik përkatës për kujdestaritë për mbulueshmëri 24h në harmoni me Ligjin e punës dhe aktet e tjera juridike me të cilat rregullohen normat e punësimit.

3. Personeli për shërbimin e anesteziologjisë dhe reanimacionit dhe kujdesit intensiv për spitalin e përgjithshëm dhe spitalin special:

- 3.1 Për Spitalet e Përgjithshme (2) dy specialist anesteziolog me orar të plotë pune;
- 3.2 Për Spitalet Speciale (1) një specialist anesteziolog me orar të plotë pune;
- 3.3 Dy teknik anesteziologjisë/infermier të aftësuar në anesteziologji me orar të plotë pune;
- 3.4 Dy infermier për kujdes intensiv me orar të plotë pune.

Neni 24

Shërbimet themelore shëndetësore në spitale

1. Shërbimet shëndetësore themelore në Spitalin e përgjithshëm:

- 1.1. Sëmundje të brendshme;
- 1.2. Kirurgji të përgjithshme;
- 1.3. Gjinekologji me obstetrikë;
- 1.4. Pediatri;
- 1.5. Njësia e kujdesit intensiv me reanimacion;
- 1.6. Emergjenca;
- 1.7. Kabineti për diagnostikim radioimazherik;
- 1.8. Laboratorin biokimik dhe hematologjik, mikrobiologji*, patologjik* dhe citologjik*;
- 1.9. Barnatorja;
- 1.10. Sterilizimi.

2. Shërbimet administratës dhe mbështetëse.

3. Shërbimet shëndetësore për Spitalin Special janë:

- 3.1. Veprimtaritë themelore shëndetësore e spitalit special;
- 3.2. Kabineti për diagnostikim radioimazherik;
- 3.3. Njësine e kujdesit intensiv për spitalet me degë operative;

3.4. Laboratori hematologjik dhe biokimik, mikrobiologjik*, patologjik* dhe citologjik*;

3.5. Barnatorja;

3.6. Sterilizimi.

4. Shërbimet administratës dhe mbështetëse.

5. Ç'do dhomë stacionare duhet të jetë e pajisura me pajisje duke u bazuar në shërbimet përkatëse që ofron institucioni.

6. Shërbimet e shënuara me yll (*) janë të domosdoshme vetëm për spitalet të cilat ofrojnë këto veprimtari.

Neni 25

Shërbimi i administratës për spitale

1. Hapësirat e dedikuara për shërbimet e administratës në spitale janë hapësirat për:

1.1 Menaxhment;

1.2 Pritje;

1.3 Informim;

1.4 Personel;

1.5 Buxhet dhe financa;

1.6 Siguri dhe cilësi të shërbimeve shëndetësore;

1.7 Sistem informativ shëndetësor;

1.8 Shërbime juridike;

1.9 Arkiv;

2. Pajisjet tjera përkrahëse për spitale janë:

2.1 Fikës zjarri në numër siç është paraparë në rregulloren për parandalimin dhe menaxhimin e zjarreve në objektet afariste;

2.2 Hidrant me pajisje përcjellëse për menaxhimin e zjarreve;

2.3 Një gjenerator automatik;

2.4 Inventor për bllokun operativ dhe kujdesin intenziv;

2.5 Autoambulancë;

2.6 Rezervuari i ujit te pijshëm dhe teknik.

Neni 26 **Shërbimet mbështetëse**

1. Në kuadrin e shërbimeve mbështetëse bëjnë pjesë:

- 1.1. Lavanteria;
- 1.2. Sigurimi;
- 1.3. Shërbimet e tjera: pastërtia, autoparku dhe parkingu;
- 1.4. Bioinxhinjia;
- 1.5. Kuzhina.

2. Shërbimet mbështetëse mund të:

- 2.1 Themelohen nga vetë institucioni;
- 2.2 Sigurohen përmes formës së kontraktimit.

Neni 27 **Barnatorja Spitalore**

Institucionet Shëndetësore përmes barnatores spitalore si njësi funksionale e institucionit shëndetësor spitalor, mund të bëjnë blerjen, furnizimin, deponimin, shpërndarjen e produkteve, pajisjeve medicinale dhe produktet e tjera, vetëm për pacientët e hospitalizuar, si dhe menaxhimin e produkteve të përdorshme.

Neni 28 **Kushtet minimale për barnatore spitalore**

- 1. Hapësira e barnatores spitalore duhet të jetë hapësirë e veçantë brenda spitalit me sipërfaqe të mjaftueshme dhe enterier të përshtatshëm për pranimin, deponimin, ruajtjen dhe dispenzimin e produkteve dhe pajisjeve medicinale dhe produktet e tjera.
- 2. Për barna narkotike dhe psikotrope duhet të ketë një hapësirë të posaçme dhe të sigurt, që pamundëson qasjen e personave të pa autorizuar.
- 3. Për barna termolabile duhet të ketë hapësirën e posaçme që mundëson ruajtjen e zinxhirit të ftohtë sipas deklaratës së prodhuesit.
- 4. Barnatorja spitalore duhet të posedojë pajisjet e përshtatshme të cilat sigurojnë mbajtjen dhe regjistrimin e temperaturës dhe të lagështisë në kufinjët e caktuar, që siguron ruajtjen adekuate të produkteve medicinale, pajisjeve medicinale dhe produktet e tjera sipas deklaratës së prodhuesve për ruajtje.

Neni 29

Stafi profesional

1.Stafi duhet të jetë i mjaftueshëm për zhvillimin e veprimtarisë dhe duhet të përbëhet nga:

1.1. Për Spitalet e përgjithshme së paku një farmacist përgjegjës, me orar të plotë të punës i cili është përgjegjës për furnizimin, pranimin, sigurinë e produkteve medicinale, pajisjeve medicinale dhe produktet e tjera.

1.2. Për Spitalet speciale së paku një person përgjegjës i kualifikuar i cili mund të jetë mjek ose farmacist, me orar të plotë të punës i cili është përgjegjës për furnizimin, pranimin, sigurinë e produkteve medicinale, pajisjeve medicinale dhe produktet e tjera.

1.3. Barnatorja mund të punësoj teknik të farmacisë, që mund të punoj në barnatore vetëm në prezencë të farmacistit.

2.Për zgjerimin e veprimtarisë, operim me narkotikë, duhet të pajiset me leje të veçantë nga AKPPM.

Neni 30

Sterilizimi qendror

1.Hapësirat për sterilizim qendror:

1.1.Paradhoma;

1.2.Evidentimi dhe etiketimi;

1.3.Përgatitja për sterilizim/ pastrim fizik;

1.4.Filtër (ndërrimi i personelit) për komunikim me pjesën sterile;

1.5.Pjesa sterile;

1.6.Hyrja në sterilizim dhe dalja të jenë të veçanta.

Neni 31

Kabineti për Radiologji

1.Kushtet e veçanta, hapësira, pajisjet dhe personeli për Kabinetin për Radiologji,

1.1Hapësira:

1.1.1Hapësirë për zhveshjen e pacientëve 2m²;

1.1.2Hapësirë për tabelën komandues së paku 2m²;

1.1.3Hapësirë në të cilën është vendosur aparati i rëntgenit me një gyp duhet të ketë sipërfaqe prej së paku 15 m²;

1.1.4Nëse në një hapësirë aparati me dy apo më shumë gypa rëntgenologjik, sipërfaqja duhet të

jetë së paku 15m²;

1.1.5 Hapësira e cila shfrytëzohet për aparatën rëntgenit për shërbimin e terapisë duhet të jetë së paku 15m²;

1.1.6 Hapësira e cila shfrytëzohet për aparate të rëntgenit për incizime të dhëmbëve fuqia elektrike e të cilave nuk është mbi 60 kv duhet të ketë sipërfaqe prej 6m² kurse nëse komandohet nga jashtë kabinës 4m²;

1.1.7 Hapësira prej 15m² në të cilën vendoset aparati i rëntgenit me fuqi 60kv për inqizimin të dhëmbëve dhe nofullave;

1.1.8 Hapësirë për personel.

1.2. Pajisjet:

1.2.1 aparat i rëntgenit për incizim trefazor me 6-12 fokusues – drejtues të fortësisë 750 deri 100 mA dhe 125 deri në 150 kV gjerësisht aparatën e rëntgenit për ndriçim rëntgenologjik krahas zmadhuesit elektrik dhe zinxhirit TV ose pajisje tjera diagnostike të cilat shfrytëzohen në rëntgenologji;

1.2.2. Tavolinë për ekzaminim rëntgenologjik;

1.2.3. Negatoskop;

1.2.4. Dorëzat e plumbta të thurura për ekzaminim Opcionale;

1.2.5. Syza;

1.2.6. Përparëse të plumbit;

1.2.7. Dozimetria;

1.2.8. Mjetet për dhënien e preparateve, kontrasteve me rrugë intervaskularë, orale dhe rektale;

1.2.9. Aparat për dhënjë të oksigjenit;

1.2.10. Komplet për anti-shok terapi;

1.2.11. Stetoskop;

1.2.12. Sfingomanometër;

1.3. Personeli:

1.3.1 Specialist i radiologjisë;

1.3.2 Teknik i radiologjisë/Infermier i aftësuar në imazheri minimum 6 muaj.

Neni 32
Kabinet për ultrazë

1. Kushtet e veçanta, hapësira, pajisjet dhe personeli për Kabinetin për ultrazë,

1.1. Hapësira:

1.1.1. Hapësira për ultrazë së paku 12m²;

1.1.2. Hapësira për personel;

1.1.3. Hapësirë për zhveshjen e pacientëve;

1.2. Pajisje:

1.2.1. aparat për ultrazë;

1.2.2. aparat për dhënje të oksigjenit;

1.2.3. stetoskop;

1.2.4. tensimetër.

1.3. Personeli:

1.3.1. Specialist i radiologjisë,

1.3.2. Teknik i radiologjisë.

Neni 33
Kabinet për tomografi të kompjuterizuar

1. Kushtet e veçanta, hapësira, pajisjet dhe personeli për Kabinetin për tomografi të kompjuterizuar,

1.1. Hapësira:

1.1.1. hapësira për tomografi të kompjuterizuar së paku 20m²;

1.1.2. hapësirë për tabelën komanduese 4m²;

1.1.3. hapësirë për personel;

1.1.4. hapësirë për zhveshjen e pacientëve;

1.2. Pajisjet:

1.2.1. aparat për tomografi të kompjuterizuar;

1.2.2. injektor automatik i mjetit të kontrastit intravenoz që aktivizohet nga komanda jashtë hapësirës ku gjendet aparati*;

1.2.3.pajisje për dhënjën e kontrastit përmes rektumit;

1.2.4.aparat për oksigjen;

1.2.5.antishok terapia;

1.2.6.stetoskop;

1.2.7.Sfingomanometër;

1.3.Personeli:

1.3.1.Specialist i radiologjisë,

1.3.2.Teknik i radiologjisë.

Neni 34 **Kabinet për rezonancë magnetike**

1.Kushtet e veçanta, hapësira, pajisjet dhe personeli për Kabinetin për rezonancë magnetike,

1.1.Hapësira:

1.1.1.hapësira për rezonancë së paku 20m²;

1.1.2.hapësirë për tabelën komanduese 4m²;

1.2.3.hapësirë për personel;

1.2.4.hapësirë për zhveshjen e pacientëve;

1.2.Pajisjet:

1.2.1.aparat për rezonancë;

1.2.2.aparat për dhënjën të oksigjenit kompatibil për përdorim në fushën e fortë magnetike;

1.2.3.antishok terapia;

1.2.4.Sfingomanometër;

1.3.Personeli:

1.3.1.Specialist i Radiologjisë;

1.3.2.Teknik i radiologjisë.

Neni 35
Kabinet për angiografi digjitale subtraksionale

1. Kushtet e veçanta, hapësira, pajisjet dhe personeli për Kabinetin për për angiografi digjitale subtraksionale,

1.1. Hapësira për angiografi subtraksionale digjitale ADS duhet të ketë:

1.1.1.Pritore së paku 15m²;

1.1.2.Hapësira prej së paku 20m² për ADS me një gyp dhe 25 m² për Ads me dy gypa të rëntgenit;

1.1.3.Dyshemeja e hapësirës së sallës ku është i vendosur aparati i ADS të jetë i shtruar me material kompakt me veti anti statike;

1.1.4.hapësirë për tabelën komanduese 4m²;

1.1.5.hapësirë për personel;

1.1.6.hapësirë për zhveshjen e pacientëve.

1.2.Pajisje:

1.2.1.ADS aparati me një gyp të rëntgenit;

1.2.2.Injektor automatik i mjetit të kontrastit intravenoz që aktivizohet nga komanda e vendosur jashtë hapësirës ku gjendet aparati;

1.2.3.Dozimetria;

1.2.4.Stetoskop;

1.2.5.Sfingomanometër;

1.2.6.Sistemi i monitorimit të punës me zemër;

1.2.7.Antishok terapia;

1.2.8.Mbrojtje nga qelqi për personelin që kryen procedurën;

1.2.9.Dritë lëvizëse për ndriçim të fushës së punës;

1.2.10.Ormanë për vendosjen e kateterave dhe materialit tjerë shpenzues;

1.2.11.Tavolinë lëvizëse prej metali që nuk korodon – rostfrei vendosjen e materialit shpenzues gjatë procedurës;

1.3. Personeli:

1.3.1. Specialist i radiologjisë;

1.3.2. Teknik i radiologjisë.

Neni 36
Ambulancë e mjekësisë nukleare

1. Kushtet e veçanta, hapësira, pajisjet dhe personeli për Ambulancën e mjekësisë nukleare

1.1.Hapësira:

1.1.1.hapësira për pajisjen së paku 15m²;

1.1.2.hapësirë për tabelën komanduese 4m²;

1.1.3.hapësire për dhënjën e izotopeve 6m²;

1.1.4.hapësirë për personel;

1.1.5.hapësirë për zhveshjen e pacientëve;

1.2.Pajisjet:

1.2.1.aparat (Gamma cammera ose SPECT/CT, PET/CT).

1.2.2.aparat për dhënjën të oksigjenit;

1.2.3.antishok terapia;

1.2.4.stetoskop;

1.2.5.Sfingomanometër.

1.3. Personeli:

1.3.1. Specialist i Mjekësisë Nukleare,

1.3.2. Teknik i radiologjisë.

Neni 37
Shërbimet diagnostike
Laboratori biokimik-hematologjik

1.Hapësirat për laboratorin biokimik hematologjik janë hapësirat për:

1.1.Marrjen e materialit min 9 m²;

1.2.Analiza laboratorike 20 m²;

2.Pajisjet bazë për laboratorin biokimik dhe hematologjik:

- 2.1.Orendi për laborator;
- 2.2.Kompjuter me printer;
- 2.3.Karrige dhe shtrat për marrjen e materialit biologjik;
- 2.4.Frigorifer me temperature të kontrolluar, ftohës (-20);
- 2.5.Termostat;
- 2.6.Banjo ujore;
- 2.7.Centrifuge përndarjen e serumit dhe plazmës;
- 2.8.Peshore analitike;
- 2.9.Sterilizator;
- 2.10.Dejonizator, autoklav (përveç nëse laborator ka siguruar ujin e dejonizuar dhe mënyrën për mënmyrën për largimin e mbeturinave);
- 2.11.Mikroskop;
- 2.12.Numërues hematologjik (8-18 parametra);
- 2.13.Spektrofotometër me gjatësi valore 300-700nm;
- 2.14.Analizator biokimik (automatik ose gjysem automatik);
- 2.15.Aparat për përcaktimin e elektrolitëve;
- 2.16.Aparat për statusin acido-bazik;
- 2.17.Aparat për elektroforezë;
- 2.18.Aparat imunokimik (EIA, LIA, ELFA);
- 2.19.Koagulometër.

3.Personeli për laboratorin biokimik hematologjik:

- 3.1.Një (1) specialist i biokimisë klinike me orar të plotë
- 3.2.Një (1) teknik laborator me orarë të plotë.

Neni 38
Shërbimet diagnostike
Laboratori mikrobiologjik

1. Hapësirat për laboratorin mikrobiologjik janë hapësirat për:

- 1.1. Marrjen e materialit 9m²;
- 1.2. Hapësira për përpunim dhe analiza 25m²;
- 1.3. Përgatitja e terreneve ushqyese 9 m²;
- 1.4. Ruajtja e materialeve 4 m²;

2. Pajisjet bazë dhe inventari për laboratorin e mikrobiologjisë:

- 2.1. Pinceta;
- 2.2. Pipeta;
- 2.3. Flakadan (bensen);
- 3.4. Mikroskop (fluorescent);
- 2.5. Enëlarëse për enë laboratorike;
